




Vaksinat COVID – Vaksinimi

Février 2021

Si kryhet vaksinimi?



Ku mund të vaksinohem?

Vaksinën mund ta merrni në një qendër vaksinimi ose nga një ekip i lëvizshëm.

Regjistrohuni në qendrën e vaksinimit pranë jush:



- Nëpërmjet telefonit: **0800009110**
(telefonatat janë pa pagesë)



- Online : www.sante.fr




- Ju mund të merrni informacione nga mjeku, farmacisti ose bashkia juaj.


Informacione praktike

Vaksina është pa pagesë për të gjithë.

Ruajeni dokumentin me emrin e vaksinës (për t'u siguruar që do merrni 2 injeksione të së njëjtës vaksinë).


Merrni me vete kartën tuaj të sigurimeve shoqërore (*carte vitale*). Nëse nuk keni një të tillë, ju përsëri mund të vaksinoheni.






Përpara vaksinimit

Në takimin për vaksinën, profesionisti do të konfirmojë që vaksina është e përshtatshme për ju.



Ata do ju përgjigjen pyetjeve tuaja dhe do ju pyesin nëse pranoni të vaksinoheni: jeni të lirë ta miratoni ose refuzoni atë.





Vaksinimi

Në mënyrë që të jeni plotësisht të mbrojtur, ju duhet të bëni 2 injeksione me një diferencë prej disa javësh nga njëra-tjetra.

Pas vaksinimit

Ka shumë pak efekte anësore të lidhura me vaksinën. Gjithsesi, për 1 ose 2 ditë, mund të ndjeni dhimbje në krah, të keni dhimbje koke ose ethe.



Nëse keni pyetje të mëtejshme, pyesni një profesionist të kujdesit shëndetësor, punonjës social, bashkinë e qytetit ose vizitoni faqen: vaccination-info-service.fr



Për të marrë vaksinën, telefononi në:

0 800 009 110

(telefonatat janë pa pagesë)

Ose vizitoni faqen:

www.sante.fr

Santé.fr